



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL
MINISTARSTVO ADMINISTRACIJE LOKALNE SAMOUPRAVE/ MINISTRY OF LOCAL
GOVERNMENT ADMINISTRATION

**Raporti nga procesi i konsultimit publik dhe paraprak për Koncept
Dokumentin për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe
Skemën e Grantit për Performancë Komunale**

Dhjetor 2020

Hyrje

Matja e performancës komunale është proces që aplikohet nga MAPL që prej vitit 2009. Matja e performancës bartë një peshë të veçantë për nga rëndësia strategjike në reformën e administratës publike. Në përputhje me legjislacionin për vetëqeverisje lokale, matja e performancës bëhet me qëllim që të sigurojë monitorim cilësor nga ana e autoritetit qendror të ofrimit të shërbimeve komunale. Në funksion të matjes qëndron Sistemi për menaxhimin e performancës komunale (SMPK) që përfshinë një numër mekanizmesh ligjor, administrativ e teknik. Aktualisht ky sistem numëron 19 fusha të matjes me 119 indikatorë të performancës, duke përfshirë: shërbimet administrative, shërbimet sociale, infrastrukturën, mjedisin, arsimin, shëndetësinë primare, zhvillimin ekonomik, parqet, rrugët etj. MAPL, së bashku me donatorë, krahas matjes aplikojnë edhe një grant stimulues për komuna, i mbështetur në rregulla të veçanta dhe i shpërndarë sipas kriterëve të meritës.

Marrë parasysh rëndësinë e matjes së performancës dhe rolit të grantit për performancë në përmirësimin e shërbimeve publike, MAPL ka hartuar koncept-dokumentin për SMPK dhe GPK. Ky koncept-dokument identifikon problemet kryesore rreth menaxhimit të performancës dhe grantit, si dhe ofron opsionet zhvillimore të cilat kërkohen të aprovohen nga Qeveria për të avancuar politikën e kësaj fushe. Koncept-dokumenti ka për qëllim ofrimin e alternativave më të mira për zhvillimin e politikave në të ardhmen, duke rritur qëndrueshmërinë e sistemit të matjes së performancës komunale dhe funksionimit afatgjatë të skemës së grantit për performancës komunale.

Koncept Dokumenti është hartuar nga Grupi Punues i udhëhequr nga Departamenti për Performancë dhe Transparencë Komunale në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Anëtarë në këtë grup kanë qenë edhe zyrtarë të tjerë nga Departamenti Ligjor i Ministrisë, Departamenti për Zhvillim të Qëndrueshëm, Departamenti për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave, Sekretariati Koordinues i Qeverisë, përfaqësues nga projekti DEMOS, organizatat e shoqërisë civile si BIRN, Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale, koordinatorë të performancës së komunave, kryesuesi i Forumit të Performancës Komunale, si dhe ekspertë të tjerë të kësaj fushe.

Ecuria e procesit të konsultimit

Koncept-dokumenti është hartuar përmes një konsultimi të gjerë me palë të ndryshme të interesit, ku janë zhvilluar intervista me shtatë kryetarë të komunave, intervista me 15 zyrtarë komunal për performancë, janë mbajtur dy procese të konsultimit me koordinatorët e performancës së 38 komunave, një takim me përfaqësues të Asociacionit të Komunave të Kosovës, një takim me përfaqësuesit e donatorëve të grantit të performancës, si dhe gjashtë takime të grupit punues. Njëherësh Koncept-dokumenti është dërguar për konsultim te 38 kryetarë të komunave si dhe është ndarë me institucionet e administratës shtetërore në procesin e konsultimit paraprak.

Finalizimi i Projekt-Udhëzimit, është lansuar konsultim në platformën elektronike të qeverisë për konsultime publike. Mundësi për të dhënë komente kanë pasur të gjithë qytetarët, organizatat dhe subjekte të tjera të interesuara. Konsultimi i këtij Projekt-Udhëzimi është bërë në pajtim të plotë me Rregulloren Nr. 05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimit publik.

Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/kontribuuesve
1. Konsultimet me shkrim/në mënyrë elektronike	15 ditë pune	2 Kontribues
2. Publikimi në ueb faqe/Platforma elektronike	15 ditë pune	0 Kontribues
3. Konsultimi paraprak	15 dite pune	3 kontribues

Përmbledhje e kontributeve të pranuar gjatë procesit të konsultimit

Kontributet për koncept-dokumentin për performancë dhe grant të performancës janë dhënë gjatë konsultimit me shkrim në mënyrë elektronike.

Çështje tjera

Të gjitha kontributet e pranuar janë shqyrtuar veç e veç, ndërsa raporti i detajuar për komentet e pranuar, është paraqitur në formë të plotë në shtojcën nr. 1 të këtij raporti.

Hapat e ardhshëm

Ky koncept-dokument, pas përmbylljes së procesit të konsultimit publik dhe paraprak, është finalizuar dhe do të procedohet për miratim të Qeveri.

Shtojca – tabela e detajuar me informatat për kontribuuesit, arsyetimet për përgjigjet e pranuar dhe të refuzuara.

Temat e konsultimit	Komentet	Kush ka komentuar	Statusi i Komenteve - pranuar, pjesërisht pranuar, nuk është pranuar	Komente (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
<p>Koncept Dokumenti për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Skemën e Grantit për Performancë Komunale</p>	<p>Gjuha e Koncept Dokumentit është në shumë raste kufizuese dhe mjaft teknike duke kërkuar një nivel të memories institucionale për të kuptuar atë. Gjithashtu, struktura duket jo e rregullt dhe nuk ka një përmbajtje koherente. Për më tepër, nuk janë dhënë fare kostot e opsioneve të trajtuara duke paraqitur në tekst vetëm shprehjen “Plotësohen pas konsultimeve publike”. Ne konsiderojmë që paraqitja e kostove duhet të bëhet para vendosjes në konsultim publik. Në këtë mënyrë, palët e treta, përfshirë ne si organizatë e shoqërisë do të mund të kishim një pasqyrë më të qartë të kostove dhe do të zgjerohej mundësia jonë për komentim.</p>	<p>Instituti për Politika Zhvilli more (INDEP)</p>	<p>Shqyrtuar</p>	<p>Koncept-dokumenti përmban mjaftueshëm informata rreth menaxhimit të performancës dhe grantit për performancë. Gjithashtu ofron shpjegime të hollësishme për problemin e identifikuar. Dokumenti është hartuar në pajtim me Udhëzuesin (doracakun) e Qeverisë për hartimin e koncept-dokumenteve. Kostoja e opsioneve nuk kërkohet të hartohet para procesit të konsultimit publik, por në fund të procesit. Kostoja financiare në këtë fazë bëhet vetëm për procesin e hartimit të politikës së re dhe jo ndikimit të saj.</p>
<p>Koncept Dokumenti për Sistemin e</p>	<p>Matja e performancës së komunave duhet të kalojë në një stad tjetër: atë të përfshirjes së</p>	<p>Instituti për Politika</p>	<p>Shqyrtuar</p>	<p>SMPK është hartuar në frymën e Objektivave të zhvillimit të Qendrueshëm. Një pjesë e</p>

Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Skemën e Grantit për Performancë Komunale	Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ).	Zhvilli more (INDEP		konsiderueshme e treguesve të këtij sistemi qëndrojnë brenda kornizës së OZHQ-së, derisa gradualisht parashihet të zgjerohet me tregues të tjerë në të ardhmen.
Koncept Dokumenti për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Skemën e Grantit për Performancë Komunale	Ne e konsiderojmë të padrejtë deklarin në Koncept Dokument që “Procesi i hartimit të projektligjeve i paraqitet rreziku i ndryshimeve që çënojnë adresimin e problemeve dhe pasojave të përcaktuara në këtë koncept, kur projekt-ligjet kalojnë në Kuvendin e Kosovës për miratim”.	Instituti për Politika Zhvilli more (INDEP	Shqyrtuar	Kjo pjesë e Koncept-dokumentit adreson një kusht apo rrethënë të ardhshme e cila supozohet se mund paraqitet me rastin e shqyrtimit të projektligjit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Pra, pavarësisht përmbajtjes së projektligjit që mund të procedohet nga Qeveria, Kuvendi është autoriteti i fundit që mund të ndryshoj përmbajtjen e tij. Një supozim i tillë bazohet në praktikën e kaluar të aktivitetit legjislativ të Kuvendit.
Koncept Dokumenti për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Skemën e Grantit për	Mangësia bazë e këtij dokumenti është gjuha shpesh herë shumë teknike dhe një listë shkurtesash që mungon që do t’i lehtësonte palëve të tjera komentimin e dokumentit. Koncept dokumenti, në këtë kuptim, është shkruar me një gjuhë që është gati ekskluzivisht teknike. Në mungesë të një Dokumenti të Konsultimit kualitativ, kjo konsiderojmë ne që mund të jetë një	Instituti për Politika Zhvilli more (INDEP	Shqyrtuar	Koncept-dokumentit përmban mjaftueshëm shpjegime për shkurtesat e përdorura. Meqë bëhet fjalë për një dokument të tipit profesional, gjuha teknike është e pashmangshme.

Performancë Komunale	faktor dekurajues për organizatat e shoqërisë civile që të japin kontributin e tyre në procesin e konsultimit publik.			
Koncept Dokumenti për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Skemën e Grantit për Performancë Komunale	Në versionin aktual, Dokumenti i Konsultimit është vetëm pjesërisht në përputhje me Rregulloren Qeveritare për Standardet Minimale në Procesin e Konsultimit Publik. Në versionet e ardhshme, ne i rekomandojmë organit qeveritar që të marrë në konsideratë thellimin më në detaje mbi çështjet e trajtuara dhe prapavinë politike të çështjes së diskutohet në objektin e konsultës. Në versionin aktual nuk ka një shpjegim të qartë rreth problematikës aktuale dhe përse politika aktuale nuk mund të qëndroj dhe nevojitet ky rishikim. Për këtë, ne i rekomandojmë Qeverisë që në versionet e ardhshme të konsultave publike, vëmendje më e madhe t'i kushtohet Dokumentit të Konsultimit.	Instituti për Politika Zhvilli more (INDEP)	Shqyrtuar	Dokumenti shpjegues i konsultimit publik jep sqarimet themelore për përmbajtjen e koncept-dokumentit të publikuar. Koncept-dokumenti i publikuar në platformë, jep shpjegimet e hollësishme rreth problemit dhe politikave opsionale.
Koncept Dokumenti për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Skemën e Grantit për	Komente të përgjithshme: <input type="checkbox"/> <i>Projektkoncept dokumenti të rishikohet për t'i përfshirë shqetësimet lidhur me gjininë.</i> Korniza ligjore për barazinë gjinore, gjegjësisht Ligji nr. 05/L -020 për barazi gjinore parasheh që parimi i barazisë gjinore dhe integritit gjinor të zbatohet në të gjitha planifikimet, buxhetimin dhe zbatimin e legjislacionit, politikave etj.	OSBE	Shqyrtuar	Koncept-dokumenti rregullon një politikë konkrete të ministrisë për vlerësimin e nivelit të të arriturave të komunave në shumë fusha të kompetencave të tyre, përfshirë edhe barazinë gjinore. Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale, i cili synohet të fuqizohet me një mbështetje të ardhshme

<p>Performancë Komunale</p>	<p>Veç kësaj, me qëllim të parandalimit dhe eliminimit të diskriminimit gjinor si dhe arritjes së barazisë gjinore, në nenin 5 (Masat e përgjithshme për parandalimin e diskriminimit gjinor dhe sigurimin e barazisë gjinore) të ligjit në fjalë parashihet që të gjitha institucionet e të gjitha niveleve të jenë përgjegjëse për:</p> <p><i>“1.3. përfshirjen e integritit gjinor në të gjitha politikat, dokumentet dhe legjislacion;</i></p> <p><i>1.5. përfshirjen e buxhetimit gjinor në të gjitha fushat, si një instrument i nevojshëm për të garantuar që parimi i barazisë gjinore të respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe caktimin e burimeve;”</i></p> <p>Andaj, rekomandojmë që shqetësimet gjinore të merren në konsideratë dhe të integrohen në Projektkoncept dokument. Për shembull, sugjerojmë që të përfshihet një referencë për kriterin e <i>buxhetimit të përgjegjshëm gjinor dhe integritit gjinor</i> si pjesë e vlerësimit të performances së komunave, ngaqë konsiderojmë se në vend të mbështetjes vetëm tek kriteri i përfaqësimit të barabartë nevojitet të vlerësohen të gjitha nuancat e barazisë gjinore</p>			<p>juridike, adreson kriteret e kërkuara gjinore përmes një fushe specifike “përfaqësimi i barabartë gjinor”, si dhe përmes treguesve në fushat e tjera duke inkorporuar elemente gjinore. Buxheti gjinor në këtë fazë të hartimit të koncept-dokumentit nuk është detyrim ligjor, pasi që nuk parasheh ndikimin e ardhshëm financiar të politikës së re të propozuar.</p>
<p>Koncept Dokumenti për Sistemin e</p>	<p>Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit</p>	<p>Zyra Ligjore (ZKM)</p>	<p>Shqyrtuar</p>	<p>Komenti është pranuar nga grupi punues. Në këtë kapitull është shtuar</p>

<p>Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Skemën e Grantit për Performancë Komunale</p>	<p>Komenti: Në këtë pjesë duhet të bëhet identifikimi i problemit si element themelor për zhvillimin e mëtejshëm të Koncept Dokumentit. Nga ky tekst nuk kuptohet problemi.</p>			<p>pjesa tekstuale e cila mundëson identifikimin e problemit.</p>
<p>Koncept Dokumenti për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Skemën e Grantit për Performancë Komunale</p>	<p>“Duke marrë parasysh numrin e madh të kompetencave komunale, të cilat monitorohen përmes këtij sistemi, i njëjti duhet të jetë i rregulluar mirë dhe të ketë siguri juridike. Ky sistem është mjaft kompleks, për shkak të aspektit organizativ, përmbajtësor, funksional dhe financiar. Për nga aspekti organizativ, në matjen e performancës janë të angazhuar numër i madh i zyrtarëve të nivelit lokal dhe atij qendror”.</p> <p>Koment: Të specifikohen qartë të gjithë mekanizmat</p>	<p>Zyra Ligjore (ZKM</p>	<p>Shqyrtuar</p>	<p>Komenti është pranuar dhe adresuar në dokument</p>
<p>Koncept Dokumenti për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Skemën e Grantit për</p>	<p>“Përmbajtja e objektivave të matjes zhvillohet në pajtim me kompetencat vetanake të komunave, të përcaktuara në ligjin për vetëqeverisje lokale, ligjet sektoriale dhe aktet nënligjore të cilat normojnë përgjegjësi të organeve komunale”.</p> <p>Komenti:Të listohet e gjithë korniza ligjore</p>	<p>Zyra Ligjore (ZKM</p>	<p>Shqyrtuar</p>	<p>Komenti është pranuar dhe adresuar në dokument</p>

Performancë Komunale				
Koncept Dokumenti për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Skemën e Grantit për Performancë Komunale	<p>“Veç kësaj, sistemi i normave juridike duhet të normoj qartë statusin e nëpunësve të performancës, funksionet e të gjitha strukturave përgjegjëse në nivel lokal dhe qendror për performancë, detyrimin që këtë përgjegjësi të kryejnë me ndërgjegje, në mënyrë profesionale, efektive, të rregullt, me kohë dhe pa trysni apo ndikime politike.”</p> <p>Komenti: Në mangësitë e legjislacionit, duhet të ofrohen të dhëna se cilat janë vështirësitë për zbatim, në mënyrë që pastaj në opsionin e rekomanduar të paraqiten propozimet për përmirësimin e dispozitave përkatëse të ligjit apo akteve nënligjore të caktuara.</p>	Zyra Ligjore (ZKM	Shqyrtuar	Koncept-dokumenti shtjellon mjaftueshëm mangësitë e legjislacionit ekzistues në lidhje funksionimin e sistemit të performancës.
Koncept Dokumenti për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Skemën e Grantit për Performancë Komunale	<p>Koment:</p> <p>Objektivat duhet të përshkruhen në bazë të synimeve shumë të qarta. Kjo do të thotë vendosjen e treguesve të qartë për ndryshimet që duhet të ndodhin. Këtu duhet të reflektojë përmirësimi dhe modernizimi i shërbimeve. Të rishikohet kjo pjese dhe të plotesohet konforme ushezuesit.</p>	Zyra Ligjore (ZKM	Shqyrtuar	Komenti është pranuar. Objektivat janë përshkruar më gjerësisht sipas rekomandimit.

Koncept Dokumenti për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Skemën e Grantit për Performancë Komunale	<p>Kapitulli 3: Opsionet</p> <p>Komenti: Në këtë fazë është paksa e vështirë të ofrohen komente pasi që nuk ka qartesi të duhur rreth opsioneve si dhe nuk është elaboruar opsioni i rekomanduar. Rrjedhimisht rekomandojmë që teksti i KD-së duhet të rishikohet dhe ristrukturohet.</p>	Zyra Ligjore (ZKM	Shqyrtuar	Vlerësohet se opsioni kryesor (i rekomanduar) është theksuar mjaftueshëm
Koncept Dokumenti për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Skemën e Grantit për Performancë Komunale	<p>Opsioni 3.3.3: Plotësim-Ndryshimi i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (tutje referuar si “LVL”) dhe Ligjit për financat e pushtetit lokale (tutje referuar si “LFPL”)</p> <p>Komenti: Ky nen opsion si dhe dy me lartë të qartësohen dhe të elaborohen- arsyetohen si opsione të këtij K.D. Me qëllim që të jenë të harmonizuara me pikën më poshtë ku bëhet krahasimi i opsioneve</p>	Zyra Ligjore (ZKM	Shqyrtuar	Është adresuar komenti
Koncept Dokumenti për Sistemin e	“ Nga 25 koordinatorë të intervistuar për këtë, 19 prej tyre theksojnë se ky funksion duhet të ushtrohet nga një zyrtar që ka pozitë të veçantë në	Komisi oneri për	Shqyrtuar	Është adresuar komenti

Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Skemën e Grantit për Performancë Komunale	<p>kuadër të administratës i cili detyrë parësore e ka zbatimin e sistemit të performancës, për shkak të volumit të madh të angazhimit dhe rëndësisë së matjes së performancës”</p> <p>Komenti:” Apo të gjendet forma e stimulimit me pagese për punën extra që e kryen”</p>	gjuhët (ZKM)		
Koncept Dokumenti për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Skemën e Grantit për Performancë Komunale	<p>“ Ndikimet në të drejtat themelore “</p> <p>Komenti: Mendoj se me futjen e zbatimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve, performanca jo e mirë, do të ndikonte sidomos te të drejtat themelore, e ato qojnë te të drejtat mjedisore dhe sociale.</p>	Komisioneri për gjuhët (ZKM)	Shqyrtuar	Është adresuar komenti
Koncept Dokumenti për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Skemën e Grantit për Performancë Komunale	<p>Me ka rastisur te lexoj komente te palëve te ndryshme lidhur me këtë koncept dokument dhe ne parim jam i mendimit qe secili zyrtar/institucion qe bën komente, ato t’i beje ne përputhje me mandatin qe ka si institucion e jo te jap komente per aspektet per te cilat nuk është i thirrur.</p> <p>Ne përputhje me këtë parim, si Departamenti i Buxhetit, ne kuadër te MFPT, ministri kjo</p>	Salvador Elmazi (Drejtori i Departamentit të Buxheti	Shqyrtuar	Koncept-dokumenti për performancë nuk rregullon vetëm çështje të cilat kanë ndikim në financat publike. Bazë e rregullimit të koncept-dokumentit dhe politikës së rekomanduar është Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale dhe Skema e Grantit për Performancë. Matja e performancës së shërbimeve të

	<p>përgjegjëse për financat publike në Kosovë, theksojmë se MPL nuk ka të drejtë ligjore të merret me këtë çështje ku konsideroj se kjo çështje bie në sferën e financave publike. Sipas këtij koncepti dokumenti, obligohet ministria përgjegjëse për financa të ndaje fonde shtese për komunat obligueshëm për çdo vit, ngjashëm si për grantet tjera komunale. Konsideroj gjithashtu se, nëse megjithatë, Qeveria vlerëson të arsyeshme këtë lloj granti të obligueshëm, atëherë, kjo të bëhet brenda Ligjit të financave lokale dhe të bëjë brenda autoritetit të ministrisë për financa.</p> <p>Gjithashtu ju informoj se qëndrimi i grupit punues për Projektligjin e financave të pushtetit lokal, ka qenë që skema e grantit të performancës komunale të rregullohet përmes LMFPP në të ardhmen dhe atë në formë diskrecionale gjegjësisht në baze të vlerësimit të nevojës për një gjë të tillë. Për më tepër, në programin qeveritar ceket se orientimi i qeverisë është që të bëhet granti i katërt për komunat gjë që na shtyn të mendojmë se a ka nevojë vërtet për një skemë të kështillë.</p>	<p>t, MFPT)</p>	<p>komunave është mandat ligjor i MAPL-së. Bazë për këtë është Ligji për Vetëqeverisje Lokale. Po ashtu, Rregullorja 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në nenin 9.5 ka përcaktuar që Ministria e Administrimit të Pushtetit lokal, ndër të tjera është përgjegjëse për të "Mbikëqyrë cilësinë e shërbimeve komunale". Konform kësaj, MAPL ka hartuar edhe Rregulloren nr.01/2020 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Skemën e Grantit të Bazuar në Performancë.</p> <p>Sa i përket planifikimit të buxhetit vjetor si pjesë e Grantit të Performancës Komunale, aktualisht një politikë e tillë është në zbatim e sipër. Përcaktimi në të ardhmen i një vlere konsistente shprehur në % në ligjin për performancë që do të planifikohej si pjesë e Grantit të Performancës Komunale, nuk ndikon në kompetencat e Ministrisë së Financave. Mbetet që ligji për performancë (politika e propozuar) të garantojë qëndrueshmërinë afatgjatë financiare</p>
--	--	---------------------	---

			<p>të Grantit të Performancës, ashtu që procedurat për menaxhimin e grantit do të trajtohen gjatë trajtimit të ligjit, në konsultim me të gjitha palët e interesit.</p> <p>Përcaktimi i Grantit të Performancës në një ligj special, nuk cenon ligjin për financat e pushtetit lokal, pasi që aktualisht në zbatim janë edhe ligje të tjera sic është ligji I Kryeqytetit dhe Ligji për Obiliqin, të cilat përcaktojnë skema të veçanta të financimit shtesë për komunat.</p> <p>Anëtarët e MAPL-së dhe projektit DEMOS të përfaqësuar në grupin punues për projektligjin e financave të pushtetit lokal, me gjithë insistimin për përfshirjen e Grantit të Performancës Komunale në këtë ligj, nuk kanë hasur në mirëkuptim të anëtarëve të tjerë të grupit, duke refuzuar idenë për këtë grant.</p> <p>Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, është ligj I përgjithshëm që rregullon aspekte të menaxhimit të financave publike, duke</p>
--	--	--	--

			<p>mos paraparë asnjë skemë të veçantë për cilindo institucion, përfshirë komunat. Andaj. Granti i Performancës nuk mund të jetë objekt i rregullimit me këtë ligj.</p> <p>Koncepti i Grantit të Katërt për komunat nuk është në vijë me qëllimin e Grantit të Performancës Komunale. Derisa i pari shqyrton opsionet për financimin e komunave në bazë të nevojës, granti i performancës merr parasysh parimin e meritës, pra është grant që fitohet dhe nuk ndahet si formë direkte për financim të rregullt vjetor nga qeveria.</p>
--	--	--	--